REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljonje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 2836 Më / Dt. 11.07.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna Rahovec / Opštine Orahovac / Municipal Rahovec

# Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

## RAPORT GJASHTË MUJOR I PUNËS

## JANAR-QERSHOR 2023

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Në kuadër të kompetencave dhe detyrave të drejtorisë, për periudhën janar-qershor 2023, Drejtoria për Mbrotje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat e saj konform planit të punës për vitin 2023. Synimet e drejtorisë për punë efikase, përgjigje në kërkesat e qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë, bashkëpunim me akterët relevantë për mbrojtje të jetës dhe pronës, intervenim i shpejtë dhe profesional, përmbyllin suksesshëm punën gjashtë mujore të DMSH dhe NJPZSH.

- Gjatë periudhës Janar-Qershor, janë inspektuar lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e Komunës, inspektimi i tillë specifikisht në pikat kyqe ku situate shihet më e rënduar bëhet disa herë në vit në mënyrë që të eliminohet rreziku për vërshime.
  Pas incizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse trajtim në ato vende ku ka pasur nevojë për ndërhyrje.
- Kemi bërë Inspektimin e rregullt të objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.
  Është kryer servisimi i parë për vitin 2023 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: Në objektet e Komunës së Rahovecit dhe zyreve të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrën e sporteve.

- Inspektori për parandalim ka pasur 7 verifikime për dhënien e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 11 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura.
- Në këtë gjashtë mujor, janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:
 -Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajt Korrik dhe Gusht,në të cilën periudhë rreziku për zjarre është tejet I madh si pasojë e temperaturave të larta.
 -Dokumenti për Ngritjen e Gatishmërisë Emergjente për muajt Korrik dhe Gusht për vitin 2023, me të dhënat e dala nga ky dokument synojmë reagim të shpejtë të NJPZSH-së në mbrojte të pronës dhe jetës dhe minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen.

- Ekipi i zjarrëfikësve gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2023, ka marrë gjithsej pesëdhjetë e gjashtë kërkesa për intervenime.

| 2023 | Zjarrë në Objekte ndërtimore | | | | | | Zjarrë në Objekte ekonomike | | | | Zjarrë në Pajisje elektrike | | | | Zjarrë në Sipërfaqe të hapura | | | | Zjarrë në Autom. | Gjith. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Banesa / shtëpi | Objekte ndimse | Plevica - Shtalla | Objekte kolektive | Oxhaqe | Të tjea | Publike | Objekte Biznesi | Objekte Industriale | Të tjera | Pajisje elektrike | Paisjet shpëmdarse | Gjeneratora | Të tjea | Mal | Bari i that | Sipërfaqe bujqsore | Të tjera | Automjete motorrike | |
| Janar | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 4 |
| Shkurt | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 2 | 2 | 2 | 5 | 0 | 14 |
| Mars | 1 | 0 | 2 | 0 | 1 | | 0 | 0 | 0 | 0 | | 1 | 0 | 0 | 1 | 4 | 0 | 0 | 0 | 10 |
| Prill | 9 | 4 | 2 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 9 |
| Maj | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Qershor | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 9 | 0 | 10 |

Më 4 Maj 2023, me një aktivitet simbolik shënuam Ditën Ndërkombëtare të Zjarrfikësve.





Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim







Drejtore e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim
Besmire Bytyçi

Rahovec
09/06/2023